

VENDIM
Nr.31, datë 21.12.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAU, BILISHT

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për SHAU, Bilisht si më poshtë :
Për ujin e pijshëm

Konsumator familjar	32 lekë/m ³ ;
Institucione buxhetore	75 lekë/m ³ ;
Ente private	90 lekë/m ³ .
2. Ky vendim hyn në fuqi me 1.1.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi